



KOMUNA DAJÇ



PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË KOMUNËS DAJÇ

P ë r m b l e d h j e

Përgatitur nga: KOMUNA DAJÇ

Mbështetur nga: Intercooperation Albania, Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor (dl dp)
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Shqipëri
URBAPLAN, Zvicër

Financuar nga: SDC – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Dajç - 2008

Realizimi Grafik: CREOstd

Shtypur në: Botime AFROJDIT



Schweizerische Eidgenossenschaft Swiss Cooperation Office Albania
Confédération suisse
Confeferazione Svizzera
Confederaziun svizra

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	4
Fjala e Përshëndetjes	5
Çfarë është dhe çfarë përfaqëson ky Plan Strategjik Zhvillimi për Komunën Dajç?	6
Profili i Komunës Dajç	7
Komuna Dajç në Kontekstin Rajonal	9
Drejtimet e Zhvillimit të Komunës Dajç sipas Vlerësimit të “Grupit të Qytetarëve”	10
Vizioni i Zhvillimit të Komunës Dajç	11
Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Komunës Dajç	12
Zhvillimi Ekonomik	13
Menaxhimi i Territorit	14
Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve	16
Forcimi i Qeverisjes së Mirë	17
Mobilizimi i Burimeve Financiare	17
Instruments for Territorial Management	18
Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Dajç	22

Hyrje

Plani Strategjik i Komunës Dajç, është përgatitur në kuadër të **Programit për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal (dldp)** në Rajonin verior të Shkodrës.

Komuna Dajç është një ndër tetë njësitë partnere të qeverisjes vendore përfutuese të këtij programi, krahas Bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Fushë-Arrëz, Koplík si dhe Komunave Velipojë e Guri i Zi.

Synimi kryesor i Programit është përmirësimi i qeverisjes qendrore në Rajonin e Shkodrës, duke u fokusuar në përmirësimin e të gjithë komponentëve të qeverisjes, menaxhimit dhe administrimit të infrastrukturave, shërbimeve, transparencën me publikun, duke mbështetur procesin e decentralizimit si dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Hartimi i Planeve Strategjike të Zhvillimit, nëpërmjet proceseve të hapura me pjesëmarrjen e qytetarëve, përbën boshtin kryesor të Programit. Qëllimi kryesor i Planeve është pajisja e autoriteteve vendore me dokumentet bazë strategjike, të cilat identifikojnë prioritetet kyçe të zhvillimit duke u orientuar drejt zhvillimit.

Në këtë proces u përfshinë përfaqësues të administratës vendore, Këshillit Vendor, grupeve të ndryshme të interesit (biznese, emigrantë, fermerë etj), përfaqësues të Qarkut të Shkodrës si një partner i rëndësishëm në zbatimin e mëtejshëm të strategjisë, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse (OJF), si dhe partnerë të tjerë që janë duke ushtruar veprimtarinë e tyre si shoqëri civile në këtë zonë.

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal në Rajonin e Shkodrës, i cili është në fazën e parë të zbatimit të tij (2006 – 2009) është financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga **Intercooperation Albania** (organizatë zvicerane jofitimprurëse që operon në rajonin e Shkodrës). **Co-PLAN**, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, me qendër në Tiranë, u kontraktua me cilësinë e ekspertit vendas për të asistuar gjashtë njësitë e qeverisjes vendore për përgatitjen e Planeve Strategjike të Zhvillimit si dhe Planet e Përgjithshëm Rregullues të qyteteve Vau i Dejës e Koplík në përputhje me termat e referencës për secilën prej tyre.



Fjala e Përshëndetjes



Të nderuar banorë të Komunës Dajç

Me një kënaqësi të veçantë konstatoj finalizimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Dajç, si një element me vlerë dhe tepër të rëndësishëm për të ardhmen tonë të përbashkët. Për më se një vit, administrata e Komunës, e mbështetur nga Qeveria Zvicerane si dhe nga bashkëpunimi i frytshëm i komunitetit vendor në zonën tonë, bënë të mundur krijimin e këtij dokumenti të rëndësishëm, të nevojshëm për zhvillimin e përbashkët, ecurinë dhe progresin. Në këtë proces të gjatë patëm kënaqësinë të bashkëpunojmë me një pjesë të madhe të komunitetit vendor të Komunës si dhe me shumë specialistë apo ekspertë të ndryshëm.

Qëllimi i këtij procesi ishte konkretizimi në mënyrë të përbashkët i një plani pune, i cili do të mund të eksplorojë në mënyrë eficiente mundësitë dhe kapacitetet ekzistuese të Komunës drejt një vizioni të përbashkët zhvillimi dhe progresi. Tashmë mbetet që së bashku të gjejmë forca dhe mundësi që të konkretizojmë dhe vëmë në zbatim atë që bashkë planifikojmë dhe detajojmë.

Në këtë proces, shpreh gatishmërinë e administratës së Komunës Dajç për t'u angazhuar seriozisht në zbatimin e detyrimeve të identifikuar në këtë plan. Në këtë aspekt, unë si kryetar i Komunës do të bëj përpjekjet e mia maksimale që të garantoj këtë angazhim, duke respektuar kështu nevojat dhe aspiratat e të gjithë banorëve të komunës dhe në mënyrë të veçantë ata që u angazhuan në këtë proces.

Duke përfunduar, gjej rastin të falënderoj të gjithë ata që bënë të mundur përgatitjen e këtij materiali. Në mënyrë të veçantë falënderimet i adresohen banorëve të Komunës, Intercooperation Albania si dhe Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, të cilët bashkërisht bënë realitet këtë dokument që ne marrim sot përpara.

Me respekt!
ARBEN GJURAJ
Kryetar i Komunës Dajç

Çfarë është dhe çfarë përfaqëson ky Plan Strategjik Zhvillimi për Komunën Dajç?

Një plan novator: për të parën herë në Komunën Dajç hartohet një Plan Strategjik duke hapur kështu rrugën për një përfaqje më të organizuar dhe të planifikuar drejt zhvillimit të saj në të ardhmen.

Një plan produkt dhe proces: ky Plan Strategjik, si një mekanizëm institucional, mbështet synimin për rritjen e mirëqenies së banorëve të Komunës Dajç. Ajo çka e bën të veçantë është se ky plan nuk është thjesht një produkt; mbi të gjitha ai është një proces në të cilin kombinohen pandërprerë nevojat dhe potencialet e banorëve si dhe të vetë Komunës për të arritur qëllimet e tyre.

Një plan vizionar: Plani Strategjik i Komunës Dajç i përgjigjet ndjesisë vizionare të komunitetit të tij në lidhje me zhvillimin. Ai i bashkëngjitet në një mënyrë më të plotë kontekstit të zhvillimit rajonal të Qarkut Shkodër, duke trajtuar elementet e zhvillimit në të gjitha fushat përkatëse. Të gjitha veprimet e propozuara në këtë Plan Strategjik orientohen sipas Vizionit të zhvillimit të Komunës Dajç si një qendër shumë e rëndësishme bujqësore për Rajonin e Shkodrës.

Një plan pragmatist: Plani Strategjik është konceptuar si një kontratë midis autoriteteve të Komunës dhe qytetarëve të saj, e cila identifikon vizionin e përbashkët, specifikon llojin, sasinë dhe cilësinë e zhvillimeve të nevojshme për përmbushjen e vizionit duke mbrojtur me çdo kusht mjedisin dhe vlerat vendore në Komunë. Ndërkohë Plani është i fokusuar në ndërtimin e një kuadri pune specifik si për të filluar ashtu edhe për të influencuar procesin e ndryshimeve në Komunë, me qëllim mbështetjen e objektivave të gjera ekonomike, sociale dhe mjedisore të komunitetit të Dajçit.

Një plan i përditësuar dhe realist: ky dokument është i pajisur me disa materiale hartografike të cilat do të shërbejnë për të lehtësuar procesin e menaxhimit të territorit si edhe me foto-imazhe të ndryshme që pasqyrojnë kushtet aktuale në vend dhe zhvillimin.



Profili i Komunës Dajç



Komuna Dajç ndodhet në Qarkun e Shkodrës dhe shtrihet në jugperëndim të qytetit të Shkodrës, në një distancë rrugore prej 22 km larg qendrës së saj. Në pjesën veriore dhe veriperëndimore të territorit të vet kufizohet me Lumin Buna dhe përtej saj me Komunën Ana e Malit, ndërsa një pjesë e saj është në kufi shtetëror me Republikën e Malit të Zi. Në pjesën lindore dhe juglindore kufizohet me Komunën e Bërdicës dhe atë të Bushatit ndërsa në jug kufizohet me Komunën e Velipojës. Komuna ka një sipërfaqe totale prej 36.5 km².




Komuna Dajç ka një popullsi të përgjithshme prej mbi 8,600 banorësh, e cila është e shpërndarë në 11 fshatrat që përbëjnë komunën, konkretisht, Dajç, Samrish i Ri, Samrish i Sipërm, Suka Dajç, Pentar, Belaj, Rrushkull, Shirq, Darragjat, Mali i Gjymtit, Mushan.


Aktiviteti kryesor në këtë zonë është bujqësia, ku pjesën më të madhe e zë blegtoria; këto përbëjnë edhe aktivitetet kryesore ekonomike të viteve të fundit në këtë komunë. Para viteve '90, Dajçi ka qenë një nga kooperativat bujqësore më të përparuara në nivel kombëtar, e favorizuar nga kushtet klimatike, toka pjellore si dhe traditat e banorëve të zonës.



Zona e Dajçit disponon burime natyrore, ujore e mjedisore të konsiderueshme. Komuna ka një shtrirje relativisht të madhe, prej 3,652 hektarësh, dhe thuhet se gjithë kjo sipërfaqe është tokë bujqësore me vlera të mira prodhuese. Komuna administron 79 Ha tokë urbane, 3,383 Ha tokë rurale dhe 190 Ha kullota. Lumi Buna përbën një ndër elementet me vlera të mëdha natyrore që gjenden në Komunën Dajç. Larmia e llojeve të kafshëve ujore, sidomos e llojeve të ndryshme të peshqve dhe larmia e popullatës së shpendëve, plotësojnë ekosistemin natyror dhe janë premisa për zhvillimin e turizmit dhe peshkimit në Lumin Buna.



Nr.	Emri	Vlera / karakteristika
1	Statusi Ligjor dhe Administrativ	Komunë
2	Vendndodhja	Qarku Shkodër
3	Sipërfaqja totale	37 km ²
4	Numri i qyteteve	
5	Numri i fshatrave	11
6	Numri i banorëve	8566
7	Numri i familjeve	2139
8	Popullsia në gjendje fizike pune	4835 (18-60 vjeç)
9	Buxheti Vjetor - 2008	19 500 000 (granti)
10	Të Ardhurat Vendore të Pritshme – 2008	4 000 000
11	Numri i Bizneseve Private	68
12	Niveli i Papunësisë	10%
13	Numri i të punësuarve në shtet	56
14	Numri i të punësuarve në sektorin privat	82
15	Niveli i emigracionit	30%
16	Gjatësia totale e rrugëve	39km (rrugë urbane)
17	Numri i Ndërmarrjeve Publike	0
18	Numri i rrjeteve të Ujësjellës-Kanalizimeve	5 (4+1)
19	Numri i të punësuarve në Bashki	18
20	Numri i institucioneve parashkollore	4
21	Numri i shkollave fillore - nëntëvjeçare	4
22	Numri i shkollave të mesme	1
23	Numri total i nxënësve	785
24	Numri i qendrave shëndetësore	3
25	Numri i spitaleve	0
26	Numri i qendrave të këshillimit	0
27	Numri i qendrave për të moshuar	0
28	Aktivitetet kryesore ekonomike	Bujqësor, blegtoral, tregti pemësh dekorative
29	Dokumente zhvillimi dhe strategji	Një dokument Strategjik i FAO-s (<i>Organizata për Ushqim dhe Agrikulturë e Kombeve të Bashkuara</i>) për Bujqësi-Blegtori. Në proces 'Green Agenda' një dokument për mjedisin
30	Nevojat kryesore në Infrastrukturë	Rehabilitim ujësjellësish e rrugësh. Mbrojtja e brigjeve të lumit Buna





Komuna Dajç në Kontekstin Rajonal

Aktualisht, Qarku i Shkodrës ka finalizuar Strategjinë e Zhvillimit për Rajonin e Shkodrës dhe të Lezhës. Ky është dokumenti themelor në të cilin përcaktohen principet dhe orientimet kryesore të zhvillimit të territoreve të gjithë këtij rajoni duke përfshirë këtu edhe Komunën Dajç. Parimet e tij themelore i referohen forcimit dhe zhvillimit të territoreve fushore, në perëndim të këtij rajoni duke u bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve ekzistuese natyrore dhe njerëzore. Strategjia përcakton kriteret kryesore për konsolidimin e rajonit multicentrik të Shkodrës, duke analizuar format e përdorimit të tokës, konsolidimit të rrjetit të qarkullimit rrugor, përmirësimit të infrastrukturave dhe shërbimeve etj.

Për sa i përket zhvillimit të rrjetit rrugor, Strategjia e Zhvillimit të Rajonit të Shkodrës identifikon rëndësinë e korridorit Autostradë Bushat – Velipojë Ulqin. Praktikisht Komuna Dajç gjendet e shmangur nga korridoret kryesore të qarkullimit të cilat krijojnë natyrshëm potenciale të ndryshme zhvillimi për zonat ku ato kalojnë. Ky aspekt thekson nevojën për t'u fokusuar në potencialet vendore ekzistuese që ka Komuna si bujqësia, blegtoria, agroturizmi etj, me qëllim rritjen e parametrave të zhvillimit të saj në të ardhmen.

Zhvillimi i sektorëve të bujqësisë dhe blegtorisë, që përbëjnë bazën e ekonomisë së Komunës, do të duhet të paraprihet nga një komunikim dhe infrastrukturë e përmirësuar në lidhje me Rajonin. Afërsia e Komunës Dajç me qytetin e Shkodrës, i cili përbën edhe tregun më të madh në rajonin verior të Shqipërisë, është një përparësi tjetër dhe një potencial orientues në zhvillimin ekonomik të Dajçit si një zonë e rëndësishme e prodhimit të produkteve bujqësore.

Drejtimet e Zhvillimit të Komunës Dajç sipas Vlerësimit të “Grupit të Qytetarëve”

- I. Orientimi i zhvillimeve të ardhshme ekonomike në Komunën Dajç me fokus kryesor rigjallërimin dhe konsolidimin e sektorëve të bujqësisë dhe blegtorisë.
- II. Riorganizimi dhe zhvillimi i fermave bazuar në identifikimin e kulturave të reja dhe përmirësimin e mëtejshëm të proçeseve të prodhimit bujqësor dhe blegtoral.
- III. Eksplorimi i mundësive të zhvillimit dhe stimulimi i turizmit me fokus agro-turizmin dhe i aktiviteteve plotësuese të nevojshme në shërbime dhe infrastruktura.
- IV. Rritja dhe zhvillimi i tregtisë bazuar jo vetëm tek prodhimet bujqësore dhe blegtorale, por dhe në trend-zhvillimin e serave si dhe të pemëve dekorative.



Vizioni i Zhvillimit të Komunës Dajç



Dajçi si një qendër e rëndësishme e prodhimit bujqësor dhe blegtoral në Rajonin e Shkodrës, ku koordinohen më së miri traditat vendase të kultivimit dhe prodhimit bujqësor e blegtoral me karakteristikat e veçanta dhe potencialet natyrore që disponon zona.

Dajçi si një bërthamë e shëndoshë komunitare rurale, me shërbime dhe infrastruktura sociale cilësore dhe ku banorët bashkëpunojnë me autoritetet për sa i përket zgjidhjes së problemeve dhe shqetësimeve të tyre.



Dajçi me një mjedis natyror të pastër e të shëndetshëm, i cili mbrohet dhe ripërtërihet nga kujdesi dhe ripërtërihet nga kujdesi dhe angazhimi i të gjithë banorëve të komunës si dhe mbështetja dhe monitorimi i kujdesshëm i autoriteteve vendore.



Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Komunës Dajç

A - NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK;

Promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të reja ekonomike në Komunën Dajç duke u përqendruar në përmirësimin e klimës së biznesit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, promovimin e sipërmarrjes vendore si dhe krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët vendas dhe të huaj.

B - NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË TERRITORIT;

Konsolidimi i qendrës urbane kryesore të Komunës Dajç në kryqëzimin e rrugës së Pentarit me rrugën kryesore të Komunës si dhe disiplinimi i ndërtimeve të ardhshme rreth kësaj qendre dhe përgjatë korridoreve rrugore duke forcuar instrumentet e nevojshëm administrativë dhe teknikë për menaxhimin dhe kontrollin e territoreve urbane dhe rurale.

C - NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE;

Rritja e cilësisë së shërbimeve publike dhe infrastrukturës fizike dhe sociale në të gjithë territorin e Komunës Dajç duke respektuar riorganizimin e territoreve të propozuar, urbane dhe rurale të Komunës.

D - NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË QEVERISJES VENDORE;

Rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe administruese të pushtetit vendor në Komunën Dajç, në funksion të respektimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, mbështetjes së të drejtave sociale të grupeve të cënueshme si dhe mbrojtjes së mjedisit

F - NË FUSHËN E RRRITJES SË TË ARDHURAVE VENDORE

Rritja e kapaciteteve të administratës së Komunës për mbledhjen e të ardhurave vendore si dhe identifikimi i burimeve të reja për financimin e projekteve të infrastrukturës dhe shërbimeve.



Zhvillimi Ekonomik

A1. Rivitalizimi i aktiviteteve ekonomike bujqësore dhe blegtorale.

- a. Promovimi i Komunës Dajç si një komunë me potenciale të konsiderueshme për prodhimin e kulturave bujqësore dhe blegtorale
- b. Përmirësimi i sistemit të të dhënave për tokën bujqësore në Komunën Dajç
- c. Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore në Komunë
- d. Promovimi i krijimit të fermave të mëdha bujqësore dhe blegtorale.

A2. Promovimi i agroturizmit si një nga mundësitë e zhvillimit të ekonomisë vendore të Komunës.

- a. Përgatitja e një plani konkret dhe të detajuar për zhvillimin e aktiviteteve agroturistike në territorin e Komunës
- b. Krijimi i mundësive financiare për zhvillimin e agroturizmit në Komunën Dajç

A3. Promovimi i kulturave të fidanëve dekorativë (planteve) si një variant i ri biznesi për zonën.

- a. Rritja e mbështetjes ndaj fermerëve që merren me kulturat e fidanëve dekorativë

A4. Mbështetja dhe fuqizimi i aktiviteteve të vogla të shërbimit në zonë si mundësi shtesë punësimi.

- a. Identifikimi i nevojave të biznesit të vogël në nivel Komune

Menaxhimi i Territorit

Drejtimet Kryesore për menaxhimin e tokave bujqësore:

B-a1. Mbrojtja e fondit të tokës bujqësore nga ndërtimet e pakontrolluara me karakter rezidencial apo shërbimesh në tokat bujqësore të Komunës

- a. Përmirësimi i sistemit të kontrollit ndaj ndërtimeve të reja në Komunë

B-a2. Orientimi i zhvillimeve të ardhshme urbane drejt qendrës së Komunës Dajç dhe aksit kryesor rrugor rajonal.

- a. informimi i banorëve me përcaktimet e Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Dajç lidhur me format e përdorimit të tokës
- b. Krijimi dhe forcimi i bashkëpunimit me Qarkun Shkodër për orientimin dhe kontrollin e zhvillimit të tokës në Komunë
- c. orientimi i zhvillimeve përgjatë aksit kryesor të propozuar në Planin Strategjik të Zhvillimit

B-a3. Mbrojtja e tokës bujqësore dhe zonave urbane nga erozioni gjërryes i lumit Buna si dhe nga degradimi apo kënetëzimi.

- a. mbrojtja e zonave të dëmtuara apo zonave të rrezikuara nga dëmtimet e mundshme në Komunë

Drejtimit kryesore lidhur me menaxhimin e territoreve urbane të Komunës:

B-b1. Rritja e dendësisë së banimit të parcelave rezidenciale të propozuara në Komunë nëpërmjet sigurimit të hapësirave të nevojshme për ndërtim brenda zonave urbane të identifikuara

- a. Të informojë publikun lidhur me kriteret e pranuar për parcelizimin dhe ndërtimin e tokës urbane të miratuar sipas vijave të verdha të reja të përcaktuara në Planin Strategjik të Zhvillimit

B-b2. Rritja e kapaciteteve për menaxhimin dhe kontrollin e zhvillimit dhe përdorimit të tokës urbane në Komunë

- b. Të forcojë autoritetin e saj lidhur me menaxhimin e territoreve urbane në Komunë

B-b3. Krijimi dhe konsolidimi i strukturave të qëndrueshme urbane, me hapësirat e nevojshme publike, sociale, të shërbimeve etj.

- a. Të përgatisë Planet Rregulluese të Fshatrave të Komunës

Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve

C-1. Konsolidimi i rrjetit rrugor të Komunës Dajç duke përmirësuar komunikimin e zonave të ndryshme urbane.

- a. krijimi i paketës së projekteve teknike për rehabilitimin e rrugëve të Komunës Dajç.
- b. orientimi i ndërtimeve të reja sipas vijave të ndërtimit të propozuara në Plan.

C-2. Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve në fshatrat e Komunës që nuk disponojnë këto lloj shërbimesh.

- a. verifikimi i situatës ekzistuese të rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e Komunës.
- b. përgatitja e projekteve teknike për rrjetin e ujësjellësit për të gjitha fshatrat e Komunës Dajç.
- c. kalimi i rrjeteve ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve të fshatrave në Dajç në pronësi të Komunës.
- d. përgatitja e projekteve teknike për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në Komunë
- e. promovimi i metodologjisë së gropave septike teknologjike

C-3. Përmirësimi i kushteve fizike të shkollave dhe kopshteve të Komunës duke rritur kështu cilësinë e mësimdhënies.

- a. krijimi i bazës teknike dhe administrative të përshtatshme për përmirësimin e kushteve të kopshteve dhe shkollave në Komunë
- b. krijimi i projekteve për financim në kopshte dhe në shkolla
- c. lobim me grupet e interesit në Komunë
- d. vlerësim i mundësive ekzistuese dhe potencialeve

C-4. Krijimi dhe konsolidimi i një sistemi për grumbullimin dhe depozitimin e mbeturinave .

- a. përgatitjen e materialeve paraprake referenciale lidhur me mundësinë e shërbimit në Komunë
- b. vlerësimi dhe përcaktimi i pikës së depozitimit të mbetjeve
- c. nisja dhe përfundimi i procesit për kontraktimin e shërbimit në zonë
- d. përshtatja me përcaktimet ligjore të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve

C-5. Mbrojtja e mjedisit dhe përmirësimi i kushteve të tij në të gjithë territorin e Komunës .

- a. përmirësimi i kushteve fizike të korridorit të gjelbër të Bunës
- b. gjelbërimi i korridoreve rrugore kryesore në Komunë në funksion të përmirësimit të imazhit të Komunës

Forcimi i Qeverisjes së Mirë


- D-1. Rritja e nivelit të transparencës nga ana e autoriteteve në Komunë;**
- a. nisja dhe konsolidimi i një procesi të qëndrueshëm të informimit të publikut në Komunën Dajç.
 - b. nisja dhe konsolidimi i procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.

Mobilizimi i Burimeve Financiare

- F-1. Përmirësimi i sistemit të informacionit mbi taksat vendore në Komunë.**
- a. përmirësimi i bazës së të dhënave fiskale në Komunën Dajç.
- F-2. Rritja e të ardhurave vendore nga taksat dhe burime të tjera potenciale për Komunën Dajç**
- a. rritja e të ardhurave nga taksat vendore (taksa e objektit dhe taksa e tokës)
 - b. krijimi i bazës së nevojshme teknike për gjenerimin e financimeve të reja

Instruments for Territorial Management

Qëllimi i materialeve hartografike është që të shprehin nëpërmjet organizimit të hapësirës territoriale objektivat kryesore ekonomike, sociale dhe ambientale të Komunës. Gjithashtu ato janë një instrument kyç për pjesëmarrjen e publikut, duke i ofruar qoftë aktorëve privatë apo publike mundësinë për të bashkëvepruar bazuar në një vision të qartë dhe të integruar.



Këto instrumenta synojnë:


- Të përcaktojnë kufijtë e zhvillimit në territorin e Komunës Dajç.
- Të përcaktojnë korridoret kryesore të transportit.
- Të përcaktojnë kategoritë e përdorimit të tokës.

PLANI STRATEGJIK I KOMUNES DAJÇ


PROPOZIM PER RRJETIN RRUGOR NE KOMUNEN DAJÇ

FRERJET RRUGORE TE PROPOZUARA


Propje 1-1 Rruga e llohes me shatërvan



Propje 2-2 Rruga me shatërvan të shtruar



Propje 2-3 Rruga me shtatë shatërvan



Kategoritë e përdorimit të tokës mund të specifikohen si në vazhdim

A. Zonat e banimit

Zonat e banimit të paraqitura në hartë ndahen në dy lloje:

1. Në llojin e parë janë të përfshira **Zonat e Konsolidimit Urban**, të cilat kanë nevojë dhe janë subjekt për hartimin e Planeve Pjesore, në të ardhmen, të Studimeve Tematike apo Studimeve të tjera specifike (si psh studime të detajuara pjesore etj...). Në të njëjtën kohë këto zona kanë nevojë të plotësohen me gjithë infrastrukturën fizike dhe sociale të nevojshme për një zonë banimi dhe shërbimet përkatëse (rrjeti rrugor, sistemi i kanalizimeve, furnizimi dhe ujë dhe energji elektrike, transporti publik, shkolla, kopshte, qendra shëndetësore e sociale etj. ...). Dendësia e propozuar bruto në këtë zonë është 100 banorë/Ha, ndërsa dendësia neto është 140 banorë/Ha. Në këtë zonë propozohet të lejohen dhe inkurajohen (duke u bazuar në politikat vendore përkatëse) ndërtime të reja me qëllim konsolidimin e zonës dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike.
2. Në llojin e dytë janë të përfshira **Zonat e Ngrirjes Urbane**, të cilat nuk paraqesin nevojë për plane të përgjithshme rregulluese pasi propozimi konsiston në reduktimin dhe ndalimin e ndërtimeve të reja në të ardhmen.

Këto propozime për orientim kanë si objektiv:

- Të ndihmojnë në konsolidimin e zonave urbane.
- Të ndihmojnë në dendësimin dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve në zonat urbane.
- Të ndihmojnë në uljen e kostove të investimeve dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturave në zonat urbane e më tej.

B. Zonat specifike:



Zonat specifike të paraqitura në hartë ndahen në dy lloje:

Zonat ekonomike: këtu do të nënkuptojmë zonat e destinuar për zhvillimin e tregtisë, industrisë së lehtë të përpunimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të zonës dhe si dhe shërbimeve përkatëse. Në rastin e Komunës Dajç këto zona janë të vendosura përgjatë rrugës kryesore të Komunës dhe pikërisht në afërsi të qëndrës së re të propozuar të saj.

Zonat e gjelbra: këtu përfshihen ato zona të gjelbra të cilat mbrohen me ligj dhe kërkojnë një vëmendje të veçantë si psh; krijimi i parku përgjatë brigjeve të lumit të Bunës, mbjellje e pemeve përgjatë brigjeve të lumit etj.

PLANI STRATEGJIK I KOMUNES DAJÇ

PROPOZIM PER ZONAT URBANE NE KOMUNEN DAJÇ



Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Dajç

Sikurse është përmendur në Kapitullin I të dokumentit, Plani Strategjik i Komunës Dajç është një plan i integruar zhvillimi për zbatimin dhe monitorimin e të cilit administrata e Komunës Dajç ka përgjegjësinë kryesore. Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të propozuara në Kapitullin e III është e nevojshme që të krijohen dhe të konsolidohen ato mekanizma institucionalë që krijojnë hapësirën ligjore dhe teknike të nevojshme. Më konkretisht propozohet sa më poshtë:

- Ngritja e **Grupit të Zbatimit dhe Monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit** të Komunës Dajç i cili do të përbëhet nga përfaqësues të administratës së Komunës, përfaqësues të Këshillit Vendor dhe përfaqësues të Grupit të Qytetarëve të angazhuar në procesin e përgatitjes së Planit. Ky grup do të ketë përgjegjësinë për koordinimin dhe monitorimin e Planit të Aktiviteteve të propozuar si dhe për garantimin e vazhdueshmërisë së zbatimit të tij. Grupi do të jetë nën lidhshmëri dhe kryetarit të Komunës si dhe të një përfaqësuesi të Grupit të Qytetarëve.
- Përgatitja e serisë së studimeve, vlerësimeve teknike, anketimeve etj. duhet të jetë atribut i një strukture të posaçme siç është **Zyra e Koordinimit-Zhvillimit** brenda administratës së Komunës. Për të mos fryrë artificialisht strukturën ekzistuese administrative të Komunës e cila ka kapacitete financiare dhe njerëzore të kufizuara, në përbërje të kësaj zyre mund të angazhohet vetëm 1 person me kohë të plotë, i cili të koordinojë punën me anëtarë të zyrave të tjera të Komunës.
- Promovimi paraprak i një Analize Institucionale e cila do të identifikojë nevojën për riorganizimin administrativ të Komunës Dajç në funksion të forcimit të përgjegjësisë dhe kapaciteteve administrative që merren me ndjekjen e angazhimeve dhe detyrave që imponon Plani Strategjik i Komunës.
- Nisja e proceseve të bashkëpunimit institucional me Komunitetin fqinj dhe Qarkun Shkodër për të identifikuar mundësitë e bashkëpunimit për ndërhyrjet apo investimet e ndryshme për përmirësimin e shërbimeve apo infrastrukturave.
- Përmirësimi i bazës së të dhënave territoriale, financiare dhe infrastrukturore në Komunë për t'i paraprirë përgatitjes së një serie projektesh teknike apo studimesh të nevojshme fizibiliteti për zbatimin e mundshëm të Planit Strategjik të Zhvillimit.
- Rritja e kapaciteteve dhe nivelit të angazhimit të stafit të Komunës Dajç sidomos në aspektin e menaxhimit dhe monitorimit të territorit dhe infrastrukturave fizike nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme apo edhe përmirësimit të sistemit të raportimit dhe vlerësimit.
- Institucionalizimi i raporteve periodike të çdo zyre lidhur me ecurinë e zbatimit të Planit Strategjik drejtuar Zyrës së Koordinimit-Zhvillimit dhe Grupit të Zbatimit dhe Monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Dajç është thelbësor për suksesin e zbatimit dhe matjen e progresit të tij. Grupi i Zbatimit dhe Monitorimit të Procesit, i ngritur brenda strukturës administrative të Komunës Dajç, do të përgatisë raportet përkatëse drejtuar Kryetarit të Komunës si dhe Këshillit Vendor.

Këshilli Vendor i Komunës Dajç, i cili është dhe organi që miraton ligjërisht Planin Strategjik të Zhvillimit sipas nevojave të veçanta, rezervon të drejtën, nëpërmjet një vendimi, për të propozuar një monitorim të jashtëm të progresit të Planit.

Tabela 5. Skema e Propozuar e Monitorimit të Planin Strategjik të Zhvillimit

Tema	Afati (periodik)	Përgjegjës
Vlerësim i aktiviteteve të gjashtëmujorit sipas Planit të Veprimit të PS	Janar-Shkurt të çdo viti	Grupi i Punës për zbatimin e PS
Vlerësim Vjetor i Zbatimit të PS	Korrik-Gusht	Grupi i Punës për zbatimin e PS

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË KOMUNËS DAJÇ

P ë r m b l e d h j e